

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Media italiane: Rasti Veli aj, drejtësia shqiptare nën lupë: rasti që vë në vështirësi Melonin
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/28/media-italiane-rasti-veliaj-drejtesia-shqiptare-nen-lupe-rasti-qe-ve-ne-veshtiresi-melonin/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:14:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:02:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a0cd02b8e3aacdfd401cedab9ae689fb5f4527a344c27a6cde7a8e7eb7b69b67
TEKSTI	5dfabcf81e8a2a7bb79c012d08907be7d9254b6be94285649917ff542d84a52
PAMJA	912c2d4c81b16a161dad9b416315bdf0ba0381df8a985744081b8398f0a2d0a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	831f2b001a2cb678d1cf6b9d911925cfc90d582130f351de9638e02c061189f9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/831f2b001a2cb678d1cf6b9d911925cfc90d582130f351de9638e02c061189f9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

M media italiane: Rasti Veliaj, drejtësia shqiptare nën lupë: rasti që vë në vështirësi Melonin

Aktualitet

Publikuar: 28/09/2026



Nga Alessio Postiglione

Shqipëria përfaqëson një gur shahu gjeopolitik themelor për Italinë e udhëhequr nga Giorgia Meloni, por problemet e shtetit të së drejtës në Tiranë rrezikojnë të minojnë strategjinë e qeverisë sonë. Hapi i gabuar – i maturuar tërësisht brenda Partisë Socialiste shqiptare, bashkëbiseduese e privilegjuar e kryeministres sonë – ka të bëjë me kryebashkiakun e kryeqytetit, Erion Veliajn.

Historia është një lloj “Tangentopoli” lokale, që hedh hije jo vetëm mbi dukuritë korruptive, por edhe mbi përdorimin politik të drejtësisë dhe abuzimin me masat e sigurimit në vendin ballkanik. Më 15 shtator të kaluar, Gjykata e Lartë shqiptare vendosi lënien në fuqi të masës së sigurimit “arrest në burg” për kryebashkiakun e Tiranës. Vendimi shpërfilli një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, e cila e kishte cilësuar paraburgimin e Veliajt “joproporcional” dhe antikushtetues shkarkimin e tij nga posti i kryebashkiakut, duke i privuar qytetarët nga përfaqësuesi i tyre i zgjedhur në mënyrë demokratike dhe zyrtarisht ende në detyrë. Veliajt iu caktua masa e sigurimit më 10 shkurt 2025, me urdhër të SPAK-ut, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ky organ, i krijuar me mbështetjen dhe financimet e Bashkimit Evropian, përbën një nga shtyllat institucionale për përafrimin me *acquis communautaire*, të nevojshëm për hyrjen e Tiranës në BE, një rrugëtim për të cilin Italia është bërë garante. Megjithatë, përtej akuzave për korrupsion që i drejtohen kryebashkiakut (të

Me të lexuarat

-  media e vëllezërve Veshaj që i blenë Fidel Yllit për 300 mijë euro, biznesmenia Basha tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys Agasit (emrat) / 39 vite drejtor /
-  Petrit Tare fshehje pasurie e pastrim parash, 15 shtëpi në Tiranë, 250 mijë shtetas e jetës së Alket Riza, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve
-  Parafaktimi tronditës i Bill Gates: Inteligjenca Artificiale mund të vrasë 1 miliard njerëz

cilat do të duhet të shqyrtohen në një proces të rregullt gjyqësor), Veliaj mbetet i privuar nga liria personale. Ajo që e bën tablonë të veçantë është motivimi i paraqitur nga SPAK-u, i cili u mbështet te mosregjistrimi i kryebashkiakut në FARA (Foreign Agents Registration Act), regjistri amerikan i lobistëve. Në këtë regjistrim ishte regjistruar në fakt një studio ligjore e lidhur me kryebashkiakun, për të mbrojtur kauzën e tij në Shtetet e Bashkuara, vend ku Veliaj ka qenë gjithmonë shumë aktiv.

Thirrja në FARA përbën megjithatë një anomali procedurale: bëhet fjalë për një detyrim burokratik amerikan që nuk përbën vepër penale as në SHBA, as në Shqipëri. Jo rastësisht, vetë Kushtetuesja shqiptare kishte dënua përdorimin joproporcional të paraburgimit. Çështja merr nuanca delikate si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Veliaj, figurë kyçe e Partisë Socialiste (PS) dhe ish-ministër, është konsideruar për vite me radhë si delfini dhe pasardhësi natyror i kryeministrit Edi Rama. Megjithatë, me kalimin e kohës, marrëdhëniet mes të dyve u përkeqësuan gradualisht dhe u shndërruan në një rivalitet të hapur për udhëheqjen. A bëhet fjalë, pra, për një abuzim gjyqësor? Për një rast drejtësie të politizuar, të zhvilluar paradoksalisht nga po ajo Prokurori që lindi për ta përafuar Shqipërinë me standardet evropiane? Një paralajmërim në këtë drejtim ka ardhur drejtpërdrejt nga Brukseli.

Eurodeputeti Sandro Gozi, sekretar i përgjithshëm i Partisë Demokratike Evropiane (PDE/Reneë Europe), ka shprehur shqetësim të fortë. Ai deklaroi se paraburgimi i zgjatur ngre “pikëpyetje serioze mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin” e masës dhe i kujtoi Ramës se “Shqipëria meriton përgjigje, një shtet të së drejtës efektiv dhe respektim të vullnetit demokratik, jo shkurtore gjyqësore”. Nuk bëhet fjalë për të përcaktuar fajësinë apo pafajësinë e Veliajt, as për të frenuar luftën e domosdoshme kundër korrupsionit, por për të kuptuar rreziqet e heshtjes mbi garancitë demokratike në Tiranë. Nëse institucioni antikorrupsion vepron përmes paraburgimesh të paqarta, instrumentalizon detyrime administrative të huaja si FARA dhe tregohet i papërshtueshëm edhe ndaj thirrjeve të vetë Gjykatës Kushtetuese të vendit, atëherë lëkundet i gjithë modeli i paraaderimit në BE. Kjo e ekspozon Italinë ndaj rrezikut të bëhet garante e pakushtëzuar e një sistemi që cenon shtetin e së drejtës.

Artikulli origjinal: <https://www.ilriformista.it/caso-veliaj-la-giustizia-albanese-sotto-esame-il-caso-che-mette-in-difficolta-meloni-532099/>

TAG:

Mediat italiane

Veliaj

Të ngjashme





Tryeza e pagave, magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës, në mbledhje do të shkojë vetëm Gjykata e Lartë



Incident i ri sigurie/ OpenAI nën hetim për agjentët e Inteligjencës Artificiale, anashkaluan filtrat e faqes së OKB-së



Çatia e banesës shembet nga flakët, humb jetën 70-vjeçari në Fier

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**

KRYESORE **POLITIKË** **EKONOMI**

ANALIZË **RAJON** **KULTURË** **SPORT**



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.